

Vendim nr. 46, datë 02.04.2026

(V- 46/26)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimimi, Marjana Semini, Sonila Bejtja, anëtarë, me sekretare Farijsja Idrizaj, në datën 02.04.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 28 (A) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **AKILE DINE**

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

AVOKATURA E SHTETIT, përfaqësuar nga Valbona Legisi dhe Irma Qosja.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm Ilir Proda.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-2457, datë 11.06.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 141 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit Akile Dine (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Avokaturës së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (*DPPSH*), të cilët kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Sipas urdhrit nr. 230/3, datë 22.06.2004 të ministrit të Brendshëm kërkuesi është ripranuar si oficer i Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë. Po ashtu, rezulton se familja e kërkuesit, e cila përbëhet nga bashkëshortja dhe vajza e tij, banon në qytetin e Korçës. Ky fakt është vërtetuar nga vërtetimi nr. 1318, datë 27.06.2014 i Bashkisë së Korçës dhe certifikata e Zyrës së Gjendjes Civile Korçë, e lëshuar në datën 18.03.2012. Ndërkohë, kërkuesi, për shkak të detyrës, ka jetuar përkohësisht në Tiranë. Në datën 20.03.2014 kërkuesi, me pretendimin se duhej të përfitonte kompensim për humbjet e pësuar nga detyra, i është drejtuar me kërkesë DPPSH-së për këtë qëllim.

2. DPPSH-ja, me shkresën nr. 1521/1, datë 26.06.2014, i ka kthyer përgjigje kërkuesit se bazuar në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 507, datë 18.07.2003 “Për kompensimin për privacionet dhe humbjet që i shkaktohen punonjësit të Policisë së Shtetit për shkak të nevojës së punës dhe të shërbimit”, të ndryshuar (VKM-ja nr. 507/2003) dhe nr. 183, datë 09.02.2011 “Për kompensimin për privacionet dhe humbjet që i shkaktohen punonjësit të Policisë së Shtetit, për shkak të nevojës së punës dhe të shërbimit” (VKM-ja nr. 183/2011), ai nuk mund të ishte përfitues i një pagese të tillë, pasi ishte ripranuar në strukturat e Policisë së Shtetit dhe nuk ishte rasti i emërimit për herë të parë dhe transferimit ose komandimit në një vend tjetër. Për këtë arsye, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me padi, me objekt detyrimin e DPPSH-së që t'i paguajë kompensimin për privacionet dhe humbjet e shkaktuara për shkak të nevojave të punës dhe të shërbimit si punonjës i Policisë së Shtetit.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 5723, datë 16.10.2014, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e DPPSH-së t'i paguajë paditësit (kërkuesit) kompensimin për largësi banimi, në formën e kompensim-udhëtimit që nga data 22.06.2004, sipas përcaktimeve të VKM-ve nr. 507/2003 dhe nr. 183/2011. Fillimisht ajo gjykatë ka marrë në shqyrtim pretendimet për parashkrimin e së drejtës së kërkesëpadisë. Sipas gjykatës, për kërkesat për kompensim financiar, referuar nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012), afatet e parashkrimit janë ato të parashikuara në ligjet e posaçme dhe konkretisht ligji nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar (ligji nr. 9749/2007) nuk ka asnjë parashikim për kërkimin për kompensim financiar. Në mungesë të përcaktimeve të shprehura në ligjet e posaçme ajo gjykatë i është referuar përcaktimeve të nenit 117 të Kodit Civil (KC), i cili përcakton një afat 10-vjeçar parashkrimi nëse nuk është

parashikuar ndryshe në ligjet e veçanta. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se bëhet falë për një kërkim për pagesë mujore, që në vetvete është i përbërë nga pagesa periodike, ndaj dhe në referencë të parashikimit të nenit 118 të KC-së, për çdo pagesë që përkon me pagesën mujore fillon një afat i ri. Në këtë kuptim, ajo gjykatë ka arsyetuar se në kushtet kur kërkesëpadia është depozituar në datën 23.06.2014, e drejta për t'u kompensuar përfshin periudhën nga data e emërimit të paditësit (kërkuesit) që është data 22.06.2004, pasi e drejta e kërimit për pagesë ka lindur nga data 22.07.2004 e në vijim. Për rrjedhojë, sipas gjykatës së shkallës së parë, kërkesëpadia është depozituar brenda 10 vjetëve nga momenti i lindjes të së drejtës. Në lidhje me themelin e mosmarrëveshjes, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në momentin e emërimit kërkuesi ka pasur të drejtë të jetë përfitues i kompensimit dhe se bazuar në VKM-në nr. 507/2003, ai e përfiton automatikisht këtë pagesë, pa pasur nevojë që të bëjë kërkesë formale për të qenë përfitues (*shih faqet 4 dhe 5 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*). Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim DPPSH-ja.

4. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 4678, datë 22.12.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 5723, datë 16.10.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e kërkesëpadiës, si të pambështetur në ligj dhe në prova. Në lidhje me afatin e paraqitjes së padisë, gjykata e apelit ka arsyetuar se duke qenë se ligji nr. 9749/2007 nuk ka të përcaktuar qartë këtë afat, ai do të llogaritet referuar dispozitave të Kodit të Punës dhe afatit të parashkrimit maksimal të parashikuar nga KC-ja. Në këtë kuptim, ajo gjykatë ka vlerësuar se kërkesëpadia është paraqitur jashtë afatit maksimal 10-vjeçar, të parashikuar nga neni 117 i KC-së, pasi është depozituar në gjykatë në datën 23.06.2014, ndërsa vendimi i të paditurës (DPPSH-së) për emërimin si oficer i Policisë Gjyqësore të kërkuesit është i datës 22.06.2004, pra është depozituar në gjykatë pas 10 vjetësh e 1 dite. Po sipas asaj gjykate, afati për paraqitjen e kërkesëpadiës (afati i parashkrimit), në rastin konkret, është ai i përcaktuar në nenin 18, paragrafi i pestë, të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit paditë për mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës paraqiten në gjykatë sipas afateve të parashikuara në legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës, i cili, si ligj i posaçëm, ka prioritet në zbatim ndaj parashikimeve të përgjithshme të KC-së. Në këtë kuptim, Gjykata Administrative e Apelit, ndryshe nga sa ka arsyetuar gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar se paditësi (kërkuesi) duhej që brenda afatit 3-vjeçar të parashikuar nga neni 203 i Kodit të Punës t'i ishte drejtuar palës së paditur ose gjykatës me kërkesën në fjalë. Ai është ripranuar në strukturat e Policisë së Shtetit në datën 22.06.2004, ndaj brenda datës 22.06.2007 duhej të bënte kërkesë për kompensim, pasi ishte subjekt i VKM-së nr. 507/2003. Sipas gjykatës së apelit, në situatën që paditësi nuk ka aplikuar gjatë kësaj periudhe, e drejta e tij për kompensim është parashkruar, për sa kohë që kompensimi nuk përfitohet automatikisht, por me kërkesë të përfituesit. Në përfundim, gjykata e apelit ka arsyetuar se bazuar në VKM-në nr. 183/2011,

subjekt i përfitimit të saj janë vetëm punonjësit efektivë që transferohen për nevoja pune dhe jo ata që janë emëruar për herë të parë ose ripranuar në strukturat e Policisë së Shtetit, ndaj kërkuesi nuk mund të jetë përfitues i pagesës bazuar në këtë akt (*shih faqet 11-12 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit*). Ndaj këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-2457, datë 11.06.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 dhe se nuk ngrihen problematika në rekurs që të bëjnë të mendohet se gjykatat më të ulëta kanë zbatuar gabim ligjin material ose procedural, dhe ky gabim të jetë i një rëndësie themelore për zhvillimin, sigurinë ose njësimin e praktikës gjyqësore. Po kështu, Kolegji Administrativ ka vlerësuar se nuk pretendohet se vendimi bie ndesh me praktikën e konsoliduar të tij ose me vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe asnjë shkelje e rëndë e normave procedurale nuk është parashtruar nga rekursuesi në mjetin e tij të ankimit përpara Gjykatës së Lartë. Në përfundim, Kolegji Administrativ ka arsyetuar se pjesa e pretendimeve në rekurs, që ngre çështje të vlerësimit të provave, del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë (*paragrafët 9-10 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

6. Në datën 20.05.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës, në datën 10.07.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

7. Në datën 13.02.2026 një prej gjyqtarëve të Gjykatës, bazuar në nenin 36, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit Organik të saj dhe nenin 18, pika 1, shkronja “a”, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, e cila është pranuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve në të njëjtën datë.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

8.1. *Së drejtës së aksesit, së drejtës për t'u dëgjuar, si dhe parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura në rekurs, megjithëse ato kishin të bënin me keqleximin, keqinterpretimin dhe zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural nga Gjykata Administrative e Apelit. Gjykatat kanë gabuar në interpretimin dhe zbatimin e ligjit material, duke i mohuar kërkuesit të drejtën për kompensim.

8.2. *Së drejtës së ankimit*, pasi në prani të dy vendimeve diametralisht të kundërta që i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme çështjes, nisur edhe nga natyra e pretendimeve të ngritura në rekurs, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhej të mbante një qëndrim të shprehur për to.

8.3. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi në vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë janë parashtruar kërkimet dhe argumentet e kërkuarit për zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykata e apelit, por nuk janë dhënë arsytet se përse ato nuk përfshihen në rastet e parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012. Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është një vendim formal.

9. ***Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit***, ka prapësuar si vijon:

9.1. Pretendimet për cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së aksesit* janë të pabazuara, pasi kërkuari ka marrë përgjigje në mënyrë shteruese për pretendimet e tij si nga gjykata e apelit, ashtu edhe nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Ato gjykata i kanë garantuar kërkuarit zhvillimin e një procesi të rregullt, sipas parashikimeve ligjore, duke arsyetuar në vendimet e tyre edhe shkaqet për vlerësimin e çështjes. Arsyetimi i Kolegjit Administrativ përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e vendimeve gjyqësore.

9.2. I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e *së drejtës së ankimit*, pasi kërkuari e ka ushtruar këtë të drejtë nëpërmjet paraqitjes së rekursit dhe shtesës së saj në Gjykatën e Lartë, e cila në vijim ka disponuar për çështjen.

9.3. I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, pasi ai nuk ka sjellë asnjë argument në mbështetje të tij, por ka parashtruar vetëm disa standarde të jurisprudencës kushtetuese. Gjithsesi, rezulton se ky parim është respektuar nga gjykatat, pasi ato i kanë krijuar kërkuarit të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbështetje të pretendimeve, njësoj si palës së paditur. Kërkuarit i është dhënë mundësia nga gjykata që të dëgjohet për provat, faktet dhe vlerësimet ligjore.

10. ***Subjekti i interesuar, DPPSH-ja***, ka prapësuar si vijon:

10.1. Pretendimet e kërkuarit të parashtruara në ankimin kushtetues individual janë të pabazuara, pasi Gjykata e Lartë, në përputhje me nenin 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, ka publikuar me shpallje njoftimin për zhvillimin e seancës në dhomën e këshillimit në datën dhe në orën e planifikuar. Në këtë kuptim, ajo gjykatë nuk ka cenuar rregullat procedurale për njoftimin e zhvillimit të gjykimit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesit

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

12. Në këtë këndvështrim, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

13. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

14. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se kërkuesi nuk legjitimohet në këtë drejtim, pasi ankimi kushtetues individual është paraqitur jashtë afatit ligjor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës. Sipas Avokaturës së Shtetit, vendimi objekt ankimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë mban datën 11.06.2024, i cili sipas shkresës nr. 4151/1, datë 08.08.2025 të asaj gjykate është bërë i disponueshëm për palët në faqen e saj zyrtare në datën 25.07.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 20.05.2025.

15. Sipas kërkesit, ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor, pasi ai ka marrë dijeni për vendimin e Gjykatës së Lartë vetëm në datën 31.03.2025, pas një verifikimi rastësor në faqen zyrtare të asaj gjykate. Po sipas kërkesit, Gjykata e Lartë, edhe pse dispononte adresën dhe të dhënat e postës elektronike të tij, nuk e ka njoftuar për vendimin e Kolegjit Administrativ të dhënë në çështjen e tij, sipas detyrimit të saj ligjor.

16. Gjykata vëren se bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit të saj Organik, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata ka pohuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket momentit të llogaritjes së afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në disa çështje kundër Shqipërisë ka konstatuar shkelje të nenit 6, paragrafi 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në drejtim të aksesit në Gjykatë, në disa raste, ku afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është llogaritur nga data e vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë dhe jo nga data kur ai i është njoftuar kërkuesit (*shih Supergrav Albania sh.p.k. kundër Shqipërisë, nr. 20702/18, §§ 17-31, datë 09.05.2023*). Në vlerësimin e asaj gjykate, i takon, së pari, Gjykatës së Lartë që të sigurojë që në dosjen e saj të çështjes të ketë prova për datën e dorëzimit të vendimit palëve (*shih Ibrahim dhe të tjerë kundër Shqipërisë, § 13, datë 14.01.2025*).

17. Gjykata konstaton se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual në datën 20.05.2025, kurse vendimi i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 11.06.2024, për rrjedhojë ankimi kushtetues individual është paraqitur pas rreth 11 muajsh nga data e marrjes së atij vendimi. Nga komunikimi elektronik me Gjykatën e Lartë, rezulton se vendimi i Kolegjit Administrativ është publikuar në faqen zyrtare të asaj gjykate në datën 25.07.2024. Nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për nevoja të këtij gjykimi kushtetues, konstatohet se rekursi në Gjykatën e Lartë është paraqitur në datën 23.01.2017 dhe në datën 30.01.2024 kërkuesi ka paraqitur në atë gjykatë një akt të titulluar “Kërkesë”, për saktësimin e një date të cituar prej tij në shkaqet e rekursit, në të cilën ka shënuar edhe të dhënat e tij të kontaktit, përfshirë të dhënat e adresës elektronike (*e-mail*). Megjithatë, pavarësisht se ka pasur në dispozicion këto të dhëna, nga aktet e dosjes gjyqësore nuk konstatohet që Gjykata e Lartë t’i ketë njoftuar kërkuesit në adresën e tij elektronike kopje të vendimit të Kolegjit Administrativ të marrë në dhomën e këshillimit për çështjen e tij.

18. Bazuar në këto fakte, si dhe në kuptim të parashikimeve ligjore e në zbatim të jurisprudencës kushtetuese dhe asaj të GJEDNJ-së, për sa kohë që kërkuesi ka depozituar në Gjykatën e Lartë të dhënat e adresës së postës elektronike (*e-mail*), dhe për sa kohë që në dosjen gjyqësore nuk ka asnjë shkresë ose akt që të provojë momentin në të cilin kërkuesi është njohur efektivisht me arsyetimin e vendimit të kundërshtuar, pra asnjë provë për datën e dorëzimit të vendimit nga Gjykata e Lartë, barra e provës në këtë drejtim nuk mund t’i kalojë kërkuesit. Për rrjedhojë, në mungesë të një prove të kundërt, Gjykata vlerëson se afati për paraqitjen e ankimit

kushtetues individual ka filluar të ecë nga data 31.03.2025, kur kërkuesi ka pretenduar se është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë nga verifikimi në faqen e internetit të asaj gjykate. Referuar asaj date (31.03.2025) dhe datës së paraqitjes së ankimit kushtetues individual (20.05.2025), konsiderohet se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, ndaj kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, është i pabazuar.

19. Për sa i takon legjitimitit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit, së drejtës së ankimit, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, si dhe parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit. Bazuar në natyrën e këtyre pretendimeve dhe në thelbin e argumenteve mbi të cilat janë mbështetur ato, Gjykata konstaton se ato kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me *standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, të cilat do të analizohen në vijim të ndërlidhura me njëra-tjetrën.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit

20. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, edhe pse në prani të dy vendimeve të gjykatave më të ulëta që u kanë dhënë zgjidhje diametralisht të ndryshme çështjes, nuk u kanë dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura në rekurs, edhe pse për nga natyra e tyre ai kolegji duhej të mbante një qëndrim të shprehur për to. Po sipas kërkuesit, vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është një vendim formal dhe nuk jep arsytet se përse argumentet e tij nuk përfshihen në rastet e parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012.

21. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar duke argumentuar se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara, pasi ai ka marrë përgjigje në mënyrë shteruese për pretendimet e tij si nga gjykata e apelit, ashtu edhe nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Sipas Avokaturës së Shtetit, arsytimi i Kolegjit Administrativ përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsytimin e vendimeve gjyqësore.

22. Subjekti i interesuar, DPPSH-ja, ka prapësuar duke argumentuar se rezultoni që Gjykata e Lartë, në përputhje me nenin 61, pika 2, të ligjit nr. 49.2012, ka publikuar me shpallje, ku njoftohej se seanca do të zhvillohej në dhomën e këshillimit në datën dhe në orën e planifikuar. Në këtë kuptim, sipas DPPSH-së, ajo gjykatë nuk ka cenuar rregullat procedurale për njoftimin e zhvillimit të gjykimit.

23. Në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të

shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, përpara së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, të arsyetuar, për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 17, datë 24.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkzioni i vendimit gjyqësor është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, duke u dhënë mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Me arsyetimin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo standardet kushtetuese, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 63, datë 23.09.2015; nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Lidhur me rastet e vendimeve diametralisht të kundërta të dhëna nga gjykatat më të ulëta, jurisprudenca kushtetuese është shprehur se në këto raste Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, ka një rol të pazëvendësueshëm, nën dritën e të drejtave të aksesit dhe të ankimit, në kuptimin substancial, si dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor (*shih vendimet nr. 73, datë 16.12.2016; nr. 62, datë 23.09.2015; nr. 4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Për shkak të këtij roli, Gjykata e Lartë, rast pas rasti, duhet t'u japë përgjigje problemeve ligjore që në praktikë lidhen me interpretimin e ligjit (*shih vendimet nr. 4, datë 28.02.2006; nr. 41, datë 29.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë

(shih vendimet nr. 11, datë 11.02.2026; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese).

25. Në këndvështrim të këtyre standardeve kushtetuese, Gjykata do të verifikojë, në vijim, nëse Gjykata e Lartë, duke pasur parasysh rolin dhe funksionin e saj si gjykatë ligji, në prani edhe të dy vendimeve që i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme çështjes së kërkuesit, u ka dhënë atyre përgjigje përfundimtare të arsyetuar pretendimeve të ngritura në rekurs, në këndvështrim të së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit.

26. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të administruara, konstaton se procesi gjyqësor objekt i këtij gjykimi është vënë në lëvizje nga kërkuesi me kërkesëpadinë, me objekt detyrimin e të paditurës, DPPSH-së, për pagesën për kompensim, për privacionet dhe humbjet e shkaktuara për shkak të nevojave të punës dhe të shërbimit si punonjës i Policisë së Shtetit, e cila është pranuar nga gjykata e shkallës së parë. Në drejtim të afatit të parashkrimit, ajo gjykatë ka vlerësuar se padia është paraqitur brenda afatit 10-vjeçar nga momenti i lindjes të së drejtës, sipas nenit 117 të KC-së, që është dispozita e zbatueshme në rastin konkret, për shkak se nuk ka asnjë rregullim për këtë afat në ligjin e posaçëm. Sipas asaj gjykate, e drejta për të kërkuar kompensim ka lindur për kërkuesin jo ditën e emërimit, por ditën që i ka lindur e drejta për të përfituar pagën e parë, pra një muaj pas emërimit e në vijim. Në lidhje me themelin e mosmarrëveshjes, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kërkuesi në momentin e emërimit ka pasur të drejtë të jetë përfitues i kompensimit dhe bazuar në VKM-në nr. 507/2003 ai e përfiton automatikisht këtë pagesë, pa pasur nevojë që të bëjë kërkesë formale për të qenë përfitues (*shih paragrafin 3 të vendimit*).

27. Mbi ankimin e DPPSH-së, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë, duke vlerësuar se afati i paraqitjes së padisë, për sa kohë nuk është përcaktuar qartë nga ligji nr. 9749/2007, llogaritet sipas dispozitave të Kodit të Punës dhe afatit të parashkrimit maksimal të parashikuar nga KC-ja. Në këtë kuptim, ajo ka vlerësuar se padia është depozituar pas 10 vjetësh e 1 dite, duke e lidhur momentin e lindjes të së drejtës ditën që kërkuesi është ripranuar në Policinë e Shtetit. Po sipas gjykatës së apelit, edhe pse ishte subjekt i VKM-së nr. 507/2003, kërkuesi e ka humbur të drejtën e përfitimit prej saj, pasi bazuar në nenin 203 të Kodit të Punës duhej të kishte kërkuar kompensim brenda afatit 3-vjeçar nga lindja e së drejtës (data e emërimit 22.06.2004), për rrjedhojë ajo është parashkruar (*shih paragrafin 4 të vendimit*).

28. Ndaj vendimit të gjykatës së apelit ka paraqitur rekurs kërkuesi, i cili ka pretenduar se Gjykata Administrative e Apelit ka bërë një interpretim të gabuar të afatit të parashkrimit dhe se referuar nenit 118 të KC-së, duke qenë se kërkimi përbëhet nga pagesa periodike, për çdo pagesë që përkon me pagesën mujore fillon një afat i ri. Ai ka pretenduar se edhe Gjykata

Administrative e Apelit ngatërron marrëdhënien e punës, duke e interpretuar gabimisht në referencë të Kodit të Punës, dhe se ka gabuar në vlerësimin dhe në interpretimin e përcaktimeve për kompensimin sipas VKM-së nr. 183/2011. Në rekurs është pretenduar se edhe gjykata e apelit e ka interpretuar gabim, duke e barazuar “kërkesën që paditësi aplikon për herë të parë për këtë trajtim”, me “të emëruarin për herë të parë në Policinë e Shtetit” dhe se ka vlerësuar dhe ka marrë *a priori* termin “ripranuar” etj.

29. Në vlerësimin e shkaqeve të rekursit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 (*shih paragrafin 5 të vendimit*).

30. Gjykata vëren se kërkuesi ka ushtruar lirisht të drejtën e tij të rekursit në Gjykatën e Lartë, ku ka parashtruar pretendimet e tij për vendimet e gjykatave më të ulëta, shkaqe që rezultojnë të kenë gjetur pasqyrimin në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Administrativ. Për sa i përket vlerësimit të këtyre shkaqeve në dhomën e këshillimit, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se kjo është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Dhoma e këshillimit njihet edhe si faza seleksionuese për shqyrtimin e rekursit në lidhje me kushtet e pranueshmërisë, ku në mungesë të ekzistencës të të cilave Gjykata e Lartë disponon për mospranimin e tij, duke i dhënë kështu fund shqyrtimit (*shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 26, datë 27.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, edhe pse me një arsyetim të kufizuar, ka vepruar në përputhje me rolin e tij dhe në ushtrim të funksionit si gjykatë ligji, si dhe në zbatim të dispozitave procedurave që rregullojnë atë formë gjykimi, duke vlerësuar se shkaqet e rekursit të ngritura nga kërkuesi nuk janë të tilla që të bëjnë të cenueshëm procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatën e apelit, për rrjedhojë duke lënë në fuqi interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga Gjykata Administrative e Apelit. Gjykata vlerëson të theksojë se pavarësisht pasaktësisë së evidentuar në vendimin e gjykatës së apelit për afatin 10-vjeçar të paraqitjes së kërkesës për kompensim, ai nuk sjell pasoja në drejtim të të drejtave substanciale që kërkuesi ka synuar të mbrojë në atë proces gjyqësor, për sa kohë po ajo (gjykata e apelit) ka vlerësuar drejt zbatimin e afatit 3-vjeçar të paraqitjes të së njëjtës kërkesë sipas nenit 203 të Kodit të Punës, si ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete, përderisa ligji i posaçëm nr. 9749/2007 nuk ka një parashikim të tillë. Për sa kohë që ky arsyetim i gjykatës së apelit nuk rezultojnë të jetë alogjik ose haptazi i paarsyeshëm, pra që të vërë në dyshim vetë thelbin e së drejtës për gjykim të drejtë, edhe vendimi i Kolegjit Administrativ që ka vendosur mospranimin e rekursit në mungesë të shkaqeve ligjore nuk vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt ligjor.

32. Duke vendosur mospranimin e rekursit për shkak se nuk përmbante shkaqet ligjore, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në thelb, i ka dhënë përgjigje kërkuarit për pretendimet e tij të ngritura në recurs. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se kërkuari ka marrë përgjigje të arsyetuara për të gjitha pretendimet e tij.

33. Lidhur me argumentin e kërkuarit se procesi i rregullt ligjor është cenuar për shkak se dy gjykatat më të ulëta kanë mbajtur qëndrime diametrisht të kundërta dhe Gjykata e Lartë nisur nga natyra e pretendimeve të ngritura në recurs, duhej të mbante një qëndrim të shprehur në lidhje me to, Gjykata thekson se ky fakt nuk përbën shkak ligjor në vetvete dhe të veçantë për cenimin e procesit të rregullt ligjor, përderisa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar tregon se i ka vlerësuar këto shkaqe, duke mos cenuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit dhe duke konfirmuar në thelb se interpretimi i ligjit nga gjykata e apelit ishte i drejtë. Vetëm fakti se Kolegji Administrativ ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit nuk është i mjaftueshëm, në këndvështrimin kushtetues, për të vënë në dyshim të drejtën për proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, si pasojë e mosprimit të rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, nuk është i bazuar.

34. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 02.04.2026

Shpallur më 08.06.2026